

VENDIM
Nr.969, datë 2.7.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË ADMINISTRIM OPERATORIT TË SISTEMIT
TË SHPËRNDARJES (OSSH), SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi OSSH, sh.a.-së, sipas lidhjeve (gjithsej 1 416 fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të sistemit të prodhimit, transmetimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH, sh.a.-së, miratuar me vendimin nr. 122, datë 4.3.2004, të Këshillit të Ministrave, të pronave të sistemit të shpërndarjes, sipas fletëve, të përcaktuara në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ndryshimin e të dhënave, në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të prodhimit dhe të transmetimit të energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH, sh.a.-së, për pronat, sipas formularëve tip (tri fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE KESH sh.a.			Identifikoi: Erion Bozgo, shef sektori (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)							
Bashkia: Tiranë			Supervizoi: Çlirim Çomo Drejtor i DPP (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)							
Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a.			Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma,vula)							
	A		B				C			
Nr. rendor	Zona kadastr.& indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja/shtrirja gjeografike	Kompetentët përbërës të pronës	Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1				Godina e Institutit të Energjetikës	Blloku “Vasil Shanto”	320 m ²	Zyra të Administratës Qendrore të KESH	METE, KESH sh.a.	KESH sh.a.	Sip. ndërtimi 320m ² një katëshe

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE KESH sh.a.			Identifikoi: Erion Bozgo, shef sektori (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Supervizoi: Çlirim Çomo, Drejtor i DPP (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)							
Komuna: Qendër - Fier			Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)							
Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a.										
	A		B				C			
Nr. rendor	Zona kadastr. & indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja/ shtrirja gjeografike	Kompetentët përbërës të pronës	Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
								METE KESH sh.a.	KESH sh.a.	
1			TEC FIER	TEC FIER	Komuna Qendër Fshati Drizë	170.950m ²	Prodhim energjie	”	”	

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

[illegible]

Shtojca nr.1

117-152;
155;
156 (pronat nr.5 e nr.6)
157;
158 (prona nr.2)
159-164;
166-177;
178 (pronat nr.2 e nr.3)
179-180;
181 (pronat nr.2, nr.3 e nr.4)
182 (pronat nr.2 e nr.3);
183-261;
263-284;
285;
286 (pronat nr.1/6, nr.1/7, nr.1/8, nr.1/9, nr.1/10, nr.1/11, nr.1/15 e nr.1/16)
287-650;
652-717;
724-782;
784-1 352.